



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-8368/22 datë:30.03.2022



Npi – 01/73 datë: 07.04.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 07.04.2022 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 07.04.2022, (e enjte) në ora 9.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Antarët e Kuvendit: z.Rahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanje Sadiku, znj.Heroina Selmani, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamed Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: Drejtoret, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati, nga Zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga OSBE z.Mefail Mustafa, nga zyra për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj, Shpëtim Gashi dhe Miftar Miftari, nga RZSH.- z.Muhamed Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.02.2022,
2. Pyetje Përgjigje,
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba për 2022, (pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit, Npi – 01//138 datë 29.04.2016 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M “Pastërtia”
Sh.a. Njësia në Shtime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës Kryesuesi në emër të Kuvendit i uroi muajin e shejtë të Ramazanit të gjithë besimtarëve musliman. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshendetje, nuk pajtohem me pikat e rendit të ditës, sepse në mbledhjen e dytë e kemi propozuar pikën rishqyrtimi i drejtive, prandaj unë propozojë sot ta qesim në votim. Dhe çështja tjetër është, pse nuk janë pikat e propozuara në përputhje me planin e punës?

znj.Adelina Beqaj; Përshendetje, në mbledhjen e kaluar ne e kemi votuar planin e punës pse po mungojnë pikat e rendit të ditës sipas planit të punës?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 1 vota “Abstenim”** aprovoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.02.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Këto fjalë që ne po i themi, nuk po shkruhen në procesverbal. Kërkojë nga sekretaria që diskutimi im të përfshihet krejt në procesverbal.

z.Reshat Mujota; Pëershëndetje, edhe unë ju urojë Ramazanin të gjithë besimtarëve në Komunën tonë. Kamë vërejtje te procesverbali sepse është shkruajtur në procesverbal se Kryetari ka replikuar me mua, jo me mua por me Përparim Ramusën, prandaj duhet të shënohet emri i atij që ka replikuar, kështu që unë jam kundër këtij procesverbali.

z.Besnik Seferi; Pëershëndetje, ky është mandati im i dytë edhe përkundër kërkesave të Kuvendit Idajetit nuk i është bërë edhe një zyrtarë që ti ndihmojë në punët e tijë, dhe tek atëherë mendojë se mundë të kërkojmë përgjegjësi nga Idajeti. Prandaj unë edhe njëherë po kërkojë nga Kryesuesi që në zyren e Kuvendit të pranoihet edhe një zyrtarë.

znj.Adelina Beqaj; Unë e kam përkrahur Idajetin që ta ketë edhe një zyrtarë në Kuvend por përderisa ky po të ndihmon ty Kryesues ky nuk ka nevojë dhe unë nuk e përkrahu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e përkrahu plotësisht kërkesën e Besnik Seferit, sepse nuk është këtu në pyetje vetëm procesverbali por ka edhe shumë punë tjera më të rëndësishme siq janë hartimi i vendimeve, rregulloreve etj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** miratoi, **Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.02.2022.**

Pika 2

Pyetje Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamed Ademaj; Kamë këto pyetje: Pjetje për DKA-në, sa është numri i puntorëve qe punojnë në shkollën e mesme të lartë me fakultet të Edukimit, pse nuk shpallet konkurs për ti zëvendësuar me Master? Pjetje për DZHE-në, sa është numri i bizneseve në Komunën e Shtimes?

z.Adem Ramadani; Kamë këto pyetje: Pjetje për Kryetarin, kanë kaluar 7 vite nga zgjedhja e Kryetarëve të fshatrave, tanë e e keni në plan zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave, dhe kurë, sepse atyre u ka kaluar mandati? Pjetje për DPUKGJ-në, Te rruga “15 Janari” është prishur një gyp i kanalizimit, e kanë ndërmend që të ndërrmarrin diqka për rregullimin e tijë?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Kamë këtë pyetje: Kam një pyetje se kurë do të asfalltohet rruga te Pishat?

znj.Adelina Beqaj; Kamë këto pyetje: Pjetje për Sekretarinë e Kuvendit, se pse mungojnë në mbledhje lista e kërkesave të qytetarëve? Pjetje për DPUKGJ-në, pse nuk po bëhet kompletimi i projektit të Kolektorit? Pjetje për DSHMS-në, pse nuk po ndihmohen familjet me assistencë sociale?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Mund të konfirmoj se 12 familje kanë kërkuar ndihmë sociale, dhe të gjithave u kemi dhënë pako ushqimore. Pjetje për Kryetarin, pse po mungojnë femrat në pozitat udhëheqëse sikurse në drejtori?

z.Rexhep Gashi; Kamë këto pyetje: Pjetje për DSHMS-në qka do të ndërrmerrni për ta rregulluar gjendjen te parking para QKMF-së?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Sa i përket parkingut para QKMF-së tani për tani nuk mund të bëjmë asgjë përfaktin se parking nuk është i ndarë fizikisht nga QPS-ë.

z.Rexhep Gashi: Pjetje për DPUKGJ-në a është pranuar teknikisht paralelja e ndarë e shkollës fillore “Lasgush Poradeci” në Gjyrkoc dhe pse nuk është funksionale?

z.Besnik Seferi; Kamë këto pyetje: Pjetje për drejtorinë për Inovacion, Sa i përket drejtorisë të Inovacionit, cilët janë hapat konkret? Pjetje për drejtorinë e Administratës, sa është numri i punëtorëve për secilën drejtori veç e veç? Pjetje për DSHP-në, Deponia në Carralevë që ka filluar të bëhet, çka po ndërrmirret për me e larguar? Pjetje për DSHP-në, Ta parku i qytetit, a është park ai apo është parking i automjeteve, qka po ndërrmerret për me i larguar automjetet që po parkohen aty? Pjetje për DSHP-në, qka do të bëhet për pastrimin e Lumin “Shtimjanja”?

znj.Adelina Beqaj; Nuk isha e kënaqur me përgjigje meqenëse ne kemi bërë një komision, kështu që unë po pyeti se deri ku ka ardhur vlersimi i komisionit. Sa i përket pëergjigjes të drejtorit të DSHMS-së për ndarjen e ndihmave për 12 familje, unë mendojë se është banale të ndahen ndihma për 12 familje kur janë mbi 200 familje për ndihma.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Këto 12 ndihma janë të veganta të tjerat marrin ndihmna të rregullta.

z.Valon Januzi, drejtor për Administratë; Përvendosje, unë përgjigjen do ta dërgojë me shkrim.

Pika 3

Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba për 2022, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën për këtë pikë ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përvendosje, ky draft i rregullores për taksa ka dalë në diskutim publik ashtu qysh ka vendosur Kuvendi. Propozime konkrete nuk ka pas sepse edhe nuk ka pas shumë pjesëmarrës. Kjo pra është e njejtë rregullore me vitin e kaluar nuk ka asnjë ndryshim të propozuar. Nëse dëshironi unë mundë edhe ti elaborojë lartësinë e taksave sipas drejtorive. Është e kuptueshme se drejtoria për Administratë ka më së shumti taksa të përfshira në rregullore sepse aty kemi certifikata të ndryshme etj po ashtu në rregullore janë të përfshira edhe lirimet e disa kategorive nga taksat komunale. Unë nuk do ta zgjati më shumë por nëse ka pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit, ZKF për elaborimin. Meqenëse kjo rregullore është e ngjajshme me atë të vitit të kaluar nuk kemi arsyë përmos me e votuar, prandaj ju sygjeroj që ta votojmë.

z.Kadri Emin; Përvendosje, kjo rregullore duhet me kalu, por përmua është shqetësuese fakti i mospjesëmarrjes të qytetarëve në debatin publik, jo vetëm këtu por edhe te diskutimet që bëhen përbuxhet. Duhet me gjetë një modalitet përmes rritjes së taksa qytetarëve nëpër debate publike. Kjo lidhet me funksionalizimin e kryetarëve të fshatrave, dhe mendoj se kjo është një mundësi e mirë.

z.Rexhep Gashi; Kjo rregullore është dokument i rëndësishëm, por fatëkeqësishtë po përcillet me një debat të vogël ose fare pa pjesëmarrje të qytetarëve. Unë megjithatë kam disa propozime, dhe propozojë që te Neni 7.2.5 Taksa prej 25 € sa ishte përmes SH.P.K propozojë të ulet në 15 euro. Te Neni 7.2.13 Taksa prej 25 € sa ishte përmes Gurethyesit, Betonjerkat, eksplotauesit e zhavorit propozojë që të rritet në 35 euro. Te Neni 8.2.4 që ka të bëjë me lirimin nga taksa Komunale, propozojë që të shtohet edhe kategoria “Ish të burgosurit politik”. Edhe duhet rishikuar çështjen e Lejeve Komunale përmes qarkullimin e Kamionëve mbi 7 ton.

z.Besnik Seferi; Po e marrë fjalën përmes hir të transparencës, dhe e përkrahu plotësishtë Kadri Eminin se duhet me gjetë një modalitet përmes rritjes së taksa qytetarëve në debatin publik, pajtohem që edhe kryetaret e fshatrave këtu kanë një rol të rëndësishëm. Mendoj se së paku ne delegatët e Kuvendit është dashur që të njoftohemi përmes debatin publik por edhe qytetarët.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit përmes informaten, kjo rregullore ka qenë në diskutim publik, nuk kanë marrë pjesë qytetarët në debat, por unë mendoj se kjo i plotëson kushtet ligjore përmiratim, dhe ne si LDK-AKR do ta votojmë.

znj. Adelina Beqaj; Për mua është shqetësuese mospjesëmarrja e qytetarëve në debat publik. Sa i përket kryetareve të fshatrave mendojë se këta duhet me pas një pagesë simbolike sa për me pasë pozitivitet për debat publik. Shpallja është bërë jashtë kornizës ligjore.

z. Bujar Ferati, ZKF; Unë nuk po e di a janë këto pyetje, a po janë propozime për ndryshimin e rregullores, sepse nëse janë propozime duhet me u votu.

z. Rexhep Gashi; Këto janë propozime të cilat duhet të qiten në votim.

z. Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përvendetje, sa i përket nenit 7.2.5 te ky nen po bëhet fjalë për vetshërbimet që janë SH.P.K (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) e që janë përafërsishtë barabar të forta me gurthyesit, prandaj unë mendojë se kjo tarifë nuk duhet të ndryshohet. Sa i përket lejeve për qarkullim të kamionave mbi shtaton ata duhet të marrin leje në Komunë te të gjithë fshatrat ku janë me shenjë të komunikacionit të ndaluar qarkullimi i tyre.

z. Rexhep Gashi; Unë jamë i vetëdijëshëm për firmat që janë SH.P.K por gurthyesit kan tjetër qarkullim, dhe mendojë se ka mundësi që ti lironjmë vetëshërbimet.

z. Hamëz Tërshani; Përvendetje, ne po e vejmë në hamendje Bujarin sepse pytjet që u bënë për lejet e qarkullimit të kamioneve mbi 7 ton janë qështje në kompetencë të drejtorisë për shërbime publike.

z. Bujar Ferati, ZKF; Sa po kuptoj unë, Rexhep Gashi po kërkon që te neni 7.2.5 Taksa prej 25 € sa ishte për, vetshërbimet SH.P.K të ulet në 15 euro. Te Neni 7.2.13 Taksa prej 25 € sa ishte për Gurethyesit, të rritet në 35 euro, ndërsa te neni 8.2.4 që ka të bëjë me lirimin nga taksa Komunale, që të shtohet edhe kategoria "Ish të burgosurit politik".

z. Asllan Beqaj; Përvendetje, Vetsheërbimet SHPK, janë supermarketet, që nuk ndryshojnë shumë nga gurthyesit, kështu që unë nuk jamë për ndryshim të rregullores sipas propozimit që e dha Rexhep Gashi.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 2 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 19 vota "Abstenim"** miratoi, propozimin e Rexhep Gashit, që te neni 7.2.5 Taksa prej 25 € për, vetshërbimet SH.P.K të ulet në 15 euro. Te Neni 7.2.13 Taksa prej 25 € për Gurthyesit, të rritet në 35 euro, ndërsa te neni 8.2.4 që ka të bëjë me lirimin nga taksa Komunale, të shtohet edhe kategoria "Ish të burgosurit politik".

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Unë po kërkoj një sqarim për sa i përket këtijë votimi, nëse miratohet propozimi i Rexhep Gashit me 2 vota dhe me 19 vota abstenim.

z. Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Sipas nenit 48 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, propozimi i Rexhep Gashit, kalon sepse votat abstenim nuk ndikojnë në rezultat por janë vetëm për të konstatuar kuorumin e Kuvendit për të marrë vendim.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Tash do ta qes në votim rregulloren në tansi së bashku me propozimet që u miratuan, në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2022, me këto ndryshime:**

1. Te Neni 7.2.5 Taksa prej 25 € sa ishte për, (Vetshërbimet SH.P.K) ulet në 15 euro.
2. Te Neni 7.2.13 Taksa prej 25 € sa ishte për (Gurethyesit, Betonjerkat, eksplotuesit e zhavorit) rritet në 35 euro.
3. Te Neni 8.2.4 Për lirim nga taksa Komunale shtohet edhe kategoria (Ish të burgosurit politik).

Pika 4

Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit, Npi – 01//138 datë 29.04.2016 për themelin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M "Pastërtia" Sh.a.

Njësia në Shtime

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se nuk kemi këtu se qka diskutojmë, sepse këtijë Komisioni i ka kaluar mandati, prandaj vetëm duhet që ta votojmë.

z.Perparim Ramusa; Unë mendojë se nuk ka pas nevojë ky propozim-vendim fare me ardhur në Kuvend, pasi që dihet se këtyre u ka kaluar mandati. Unë propozojë që në mbledhjen e radhës me i pru emrat që duhet ti propozojë kryetari dhe ta miratojmë komisionin e ri.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, unë mendojë se fillimi shifqizohet vendimi për zgjedhjen e komisionit të mëparshëm e pastaj të zgjedhet komisioni i ri.

z.Perparim Ramusa; Nuk ka gjë të keqe që ka ardhur ky propozim-vendim në kuvend por dihet se me kalimin e mandatit ata më nuk janë antarë të komisionit dhe mandati i tyre ka përfunduar.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Me të drejtë e tha Përparim Ramusa se mandati i këtij komisioni ka përfunduar, por ky propozim vendim për shfuqizim ka ardhur vetëm për të qartësuar pozicionin e tyre dhe që të mos ketë ndonjë keqperdorim eventual të pozitës së tyre.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi vendimin për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/93 datë: 30.04.2018, për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike K.R.M “Pastërtia” Sh.a. Njësia në Shtime.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi, mbledhjen e përfundoi në ora 10.28h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi